



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja, nr. 08

Prishtinë, më 29.6.2015, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Danush Ademi, Donika Kadaj-Bujupi, Albulena Haxhiu dhe Milena Miliqeviq.

Munguan: Selvije Halimi dhe Enver Hoti.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ilir Deda – deputet; Kaltrina Ahmeti – GLPS; Arta Krasniqi – OSBE; Visar Rushiti – GAP; Dibran Istrefi – Klan Kosova, Driton Asllanaj-Radio Dukagjini dhe Erdi Pirana – praktikant.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Kryetari tha se tani para vetes e keni tekstin e Projektligjit me ndryshimet që kanë dalë nga punëtorja. Duke arsyetuar secilin ndryshim, ai tha se ajo se çfarë ka mbet e hapur për diskutim, është neni 5, përkatësisht shprehja “rezolutë”

Albulena Haxhiu, ishte e mendimit që rezolutës duhet dhënë karakter detyrues sepse nuk ka kuptim vota në Kuvend nëse nuk e ka karakterin detyrues, ndërsa e këtij mendimi ishte dhe deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Armend Zemaj, tha se për komision, le të shkojnë dy versionet dhe Komisioni vendos a do ti jep karakter detyrues rezolutës apo jo.

Ilir Deda, arsyetoi propozimet e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Kreun VI, për të cilin është kërkuar komente. Duke arsyetuar secilin propozim të Komisionit për Integritet Evropian, ai lexoi propozimet. Në nenin 13, tha se kemi rekomanduar të shtohet paragrafi i ri me këtë përmbajtje:” 3. Komisioni për Integritet Evropian i Kuvendit të Kosovës, autorizon paraprakisht qëndrimin negociues të Qeverisë për negociimin e marrëveshjeve që ndërlidhen me procesin e integritetit evropian.” Po ashtu, tha se kemi propozuar që të riformulohet në tërësi neni 17, si vijon:

Neni 17

Themelimi, Përbërja dhe Kompetencat e Komisionit Parlamentar të Stabilizim Asociimit

1. Kuvendi, sipas MSA-së do të themelojë Komisionin Parlamentar të Stabilizim Asociimit.
2. Anëtar të delegacionit të Kuvendit në Komisionin Parlamentar të Stabilizim Asociimit, do të jenë të gjithë anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian dhe katër kryetarë të Komisioneve Parlamentare përkatëse, që kanë të bëjnë me zbatimin e MSA-së.
3. Kompetencat e Komisionit Parlamentar të Stabilizim Asociimit, do të caktohen me rregulloren e punës së Komisionit.”

Pas diskutimeve, me propozim të Kryetarit Nënkomisioni vendosi që neni 17 i Projektligjit, të riformulohet si vijon:” 1. Kuvendi sipas MSA-së, do të themelojë Komisionin Parlamentar të Stabilizim Asociimit.

2. Anëtarë të delegacionit të Kuvendit në Komisionin Parlamentar të Stabilizim Asociimit do të jenë të gjithë anëtarët e komisionit përgjegjës për çështjet e integritetit në BE dhe 9 (nëntë) anëtarë të komisioneve përkatëse, që kanë të bëjnë me zbatimin e MSA-së.

Në fund, Nënkomisioni vendosi të procedojë për shqyrtim në Komision, Projektligjin për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

3. Të ndryshme.

Në këtë pikë, nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:05

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj